

**AKTI I THEMELIMIT  
të  
Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar:  
STUDIO M&H CONSULTING SHPK**

**NENI 1**

Në Sarandë sot më datën 25.04.2023, shtetasit e poshtëshënuar, me vullnet të lirë dhe të plotë krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar:

**STUDIO M&H CONSULTING SHPK.**

**NENI 2**

Selia Qendrore e shoqërisë: **STUDIO M&H CONSULTIN SHPK** do të jetë në adresën: Vlorë, Sarandë, Lagja Nr.4, Rruga "Apostol Çuni", Nr.11.

**NENI 3**

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është pa afat të përcaktuar, duke filluar afati nga dita e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Q.K.B. për të bërë shënimet e nevojshme.

**NENI 4**



Objekti i veprimtarisë së shoqërisë tregtare: **STUDIO M&H CONSULTING SHPK** do të jetë:

- a) Studime urbanistike, studime të ndikimit në mjedis dhe vlerësimi, studim fezibilitetit, analiza makroekonomike dhe planifikimi, strategjia e zhvillimit në sistemin rajonal, kombëtar dhe ndërkombe.
- b) Shërbimi i projektimit të objekteve industriale e prodhuese të çdo destinacioni, projektimi për ndërtimë civile të çdo lloji, projektimi për ndërtimë portuale, projektimi për objekte hidro, hidroteknike, detare, lumore etj.
- c) Mbikqyrje punimesh për objekte të çdo kategorie. Kolaudim punimesh për objekte të çdo kategorie.
- d) Studim fizibiliteti, studime urbanistike dhe proçese të tjera të kësaj natyre.
- e) Restaurim monumentesh kulture.
- f) Rikonstruksion objektesh civile e industriale të cdo lloji shteterore dhe private.
- g) Ndertime objektesh e veprash të llojeve të ndryshme industriale dhe civile, shtetërore dhe private.

**NENI 5**

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mij) lek, formuar dhe nënshkruar nga 2 (dy) ortakë ose 2 (dy) kuota.

- Ortaku themelues: FOTO MANGLLARA: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesëdhjet mijë) Lekë që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ortaku themelues: LULEZIM HOXHAJ: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesëdhjet mijë) Lekë që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Page | 1

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### NENI 6

Kapitali Themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr Asambleja e Ortakëve, i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në regjistrin përkatës. Në këto raste, vendimi merret nga ortakët që përfaqësojnë 100% të kuotave të kapitalit themeltar.

#### NENI 7

Ortaket duhet të bëjnë përpjekje përritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajnë sekretin e saj dhe të mos të dëmtojne interesat e personave të tjera të shoqërisë.

#### NENI 8

Shoqëria çel llogari bankare në lekë dhe në çdo lloj valute të huaj, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim përritjen e kryer veprimet e nevojshme përritjen dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

#### NENI 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- 1-Asambleja e Ortakëve;
- 2-Administratori;

Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe Administratorit do të përcaktohen në statutin e shoqërise tregtare **STUDIO M&H CONSULTING SHPK.**

#### NENI 10

Shoqëria do të drejtohet nga 1(një) Administrator përritjet e afat 5 (pesë) vjeçar:  
Administratori do të jetë: Z.BESNIK SELISHTAJ

#### NENI 11

Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe per gjithësish ortakët duhet ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërtën kompetente përritjet e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesor Sarandë.

#### NENI 12

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, veçanërisht me ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtarë" (të ndyshuar).

#### NENI 13

Ky akt themelimi do të hyjë në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

#### NENI 14

Akti i themelimit u përpilua në 2 (dy) kopje dhe u nënshkrua rregullisht nga ortakët themelues.

**FOTO MANGALLARA**



**Themeluesit e Shoqërisë**

**LULEZIM HOXHAJ**

